



PLANI I ZHVILLIMIT I BASHKISE KUKES



PLANI I VEPRIMIT PER VITET
2011-2015
BASHKIA KUKES

Tetor 2012

I. PERMBAJTJA E LENDES	
II. Parathënie.....	4
III. Plani i veprimit bashkia kukes	8
A. Hyrje – Vlerësim i përgjithshëm.....	8
IV. Hapat e ndjekur ne hartimin e Planit te Veprimit (PV)	12
V. Përmbledhje e profilit të Bashkise Kukës.....	13
A. Historiku i qytetit të Kukësit.....	13
B. Pozicioni gjeografik dhe karakteristikat natyrore	13
1. Pozita gjeografike	13
2. Karakteristikat natyrore	14
C. Popullsia.....	14
D. Ndihma ekonomike	15
E. Strehimi dhe urbanizimi.....	16
F. Furnizimi me Ujë te pijshëm.....	16
G. Rrjeti i kanalizimeve	16
H. Burimet dhe përdorimi i energjisë	17
I. Sistemi arsimor	17
J. Shendetet publik	18
K. Mjedisi	19
1. Gjelbërimi.....	19
L. Mbetjet urbane	21
M. Infrastruktura rrugore	22
N. Bizneset dhe punësimi	22
O. Te ardhurat e Bashkisë Kukës.....	23
P. Shperndarja e buxhetit per vitin 2012.....	24
VI. VIZIONI per vitin 2015	25
A. Objektivat e përgjithshëm të zhvillimit te Bashkisë Kukës	25
VII. Matrica e projekteve sipas premtimeve te Kryetarit te Bashkise Kukës	26
VIII.Vendimi i keshillit bashkiak per miratimin e planit te veprimit	38

II. PARATHËNIE

Plani i Veprimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Kukës është realizuar në kuadër të projektit “Fuqizimi i Rolit të Komunitetit në Planifikimin Strategjik për Zhvillimin Lokal” i financuar nga Balkan Trust for Democracy dhe implementuar nga RASP (Program Mbështetjes së Shoqatave Rurale), dhe është realizuar në bashkëpunim me Qendrën Progres Kukës, dhe Bashkinë Kukës.

Balkan Trust for Democracy (BTD) është një iniciativë me një histori veprimtarie 10 vjeçare, që mbështet demokracinë, qeverisjen e mirë dhe integrimin Euroatlantik në Europën Juglindore. Ky partneritet publiko-privat, që ka fituar mjaft çmime është krijuar fillimisht në vitin 2003 nga German Marshall Fund i SH.B.A, Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Kombëtar (USAID) dhe Fondacioni Stewart Mott.

RASP (Programi i Mbështetjes së Shoqatave Rurale) është një organizatë me qendër në Tiranë, misioni i së cilës mbështetet në stimulimin e mundësive për banorët e zonave rurale për të përmirësuar jetesën dhe reduktuar varfërinë, nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore, kulturore dhe njerëzore për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. RASP ka një eksperiencë të gjatë në zhvillimin e projekteve me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit dhe në fokus të këtyre projekteve është zhvillimi i zonave rurale, forcimi i demokracisë dhe rolit të shoqërisë civile në planifikim, hartim dhe implementim të dokumentave strategjike, planeve të zhvillimit, veprimit të zonave ku ata jetojnë .

Qendra Progres është një shoqatë joqeveritare me shtrirje aktivitetesh në Kukës, Has, Pukë, Tiranë, Butrint-Sarandë etj që ka si objektiv stimulimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, njerëzore dhe kulturore për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet sigurimit të shërbimeve dhe implementimit të projekteve. Veprimtaria e Progres është e përqëndruar kryesisht në zhvillimin e zonave rurale nëpërmjet fuqizimit të grupeve, shoqatave, komunitetit dhe formave të tjera të shoqërisë civile që përfaqësojnë dhe i shërbejnë zhvillimit të zonave rurale.

Synimi i këtij dokumenti është të ofrojë Pushtetit vendor, Qeverisë shqiptare, donatorëve bilateral dhe multilateral, organizatave Qeveritare dhe jo Qeveritare një program zhvillimi për promovimin e mbështetjes dhe investimeve të shërbejë si një mekanizëm planifikues, i cili kombinon prioritetet sipas sektoreve dhe fshatrave, prioritetet të cilat janë artikuluar nga drejtues të organeve vendore.

Bashkia e Kukësit ka një potencial të madh zhvillimi, me bukuri të vecante natyrore dhe në këtë kuadër Plan i Zhvillimit dhe Veprimit të Bashkisë

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Kukës synon të përmbledhë të gjitha prioritet e zones në një “dokument” të vetëm që do shërbejë si një guidë në zhvillimin e komunes ne te ardhmen. Me mbështetjen e pushtetit lokal është realizuar një proces pozitiv për hartimin e këtij plani me nje pjesemarrje te gjere te komunitetit duke zbatuar Kodin e praktikës së mirë në të gjitha hallkat e tij si Përcaktimi i axhendes, Draftimi, dhe miratimi, dhe ky proces do të vazhdojë edhe me fazat e Implementimit, Monitorimit dhe Riformulimit.

Bashkia Kukës



Bashkia e Kukësit për pozicionin gjeografik ku ndodhet, për trashëgiminë kulturore dhe qytetare që ka shquhet për një mjedis të shëndetshëm për pastërti dhe kulturë në ruajtjen e vlerave dhe pasurimin e tyre të përditshëm.

Në dhjetëvjeçarin e fundit, zhvillimet urbane sollën një rritje dhe zgjerim të qytetit, duke shtuar njëkohësisht dhe numrin e ndërtimeve të reja. Kjo ka sjellë natyrshëm shfaqjen e shumë problemeve mjedisore si amortizimin e rrugëve, rrjetit të ujësjellësit, rrjetit të kanalizimeve, rritjen e ndotjes nga mbeturinat urbane, etj.

Bashkia e Kukësit duke qenë e lidhur drejtpërsëdrejti me problemet dhe shqetësimet qytetare, ka qenë gjithmonë në korrent të tyre dhe është përpjekur që, me mundësitë e saj financiare të zgjidhë problemet më emergjente, por pa pasur një plan zhvillimi aftmesëm si dhe mundësi financiare për hartimin dhe zbatimin e këtij plani.

Hartimi i këtij plani do të bëjë të mundur zgjidhjen hap pas hapi të shume problemeve egzistuese. Këtë zgjidhje e mbështetim në pjesëmarrjen e gjerë të publikut në diskutim dhe vendimmarrje në përcaktimin e prioriteteve si dhe në ndihmën teknike dhe financiare që Qeveria Shqiptare dhe donatorë të ndryshëm do na japin për këtë qëllim.

Ky plan vlersohet jo si produkt, por si nje proces i saponisur dhe i pandërprerë që do të ketë gjithnjë nevojë për ndërhyrje, përmirësime e përsosje të mëtejshme.

Ne vlerësojmë iniciativen e organizates “Programi i Mbeshtetjes se Shoqatave Rurale” (RASP) dhe punën konkrete të bërë nga Qendra ”PROGRESS”, që mundësoi realizimin e këtij Plani Veprimi si dhe perpjekjet e gadishmërinë e specialistëve të bashkisë, të specialistëve të tjerë të fushave të ndryshme, shoqërisë civile, përfaqësuesit e grupeve të interesit etj, që kanë dhënë kontributin e tyre në nxjerrjen e të dhënave, analizat specifike dhe përcaktimin e orientimeve mbi perparësitë e zhvillimit.

HASAN HALILAJ
KRYETARI I BASHKISE

III. PLANI I VEPRIMIT BASHKIA KUKES

A. Hyrje – Vlerësim i përgjithshëm

Plani i Zhvillimit të Bashkisë Kukës përfshin mbështetjen për planifikimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike, reformat administrative dhe ato të menaxhimit, si dhe rritjen e komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve drejt një qeverisjeje lokale me të përgjegjëshme dhe transparente.

Qëllimi i këtij dokumenti është pajisja me një dokument udhërrëfyes, i cili identifikon prioritetet kyç të zhvillimit të ardhshëm të Bashkisë, duke orientuar çështje si ato të zhvillimit ekonomik, ndërhyrjet për përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen dhe kapacitetet e nevojshme të shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit, etj.

Plani i Zhvillimit të Bashkisë Kukës është përgatitur gjatë një procesi të hapur pjesëmarrjeje disamujore, i udhëhequr nga grupi i punës, i përfshirë në një cikël takimesh debatuese dhe konsultative. Ekipi i përbashkët i punës përfshiu përfaqësues të administratës vendore të Bashkisë Kukës, Këshillit të Bashkisë, grupe të ndryshme interesi lokal (intelektual, biznesmenë, gra, të rinjë nga universiteti dhe shkalla e mesme pensioniste etj), përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse (OJF) si dhe partnerë të tjerë që janë duke ushtruar veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë. Ekspertë nga organizatat e përmendura më sipër dhanë kontributin e tyre teknik në mbështetje të projektit.

Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit, bazuar në forma jodiskriminuese dhe paanshmëri në lidhje me moshën, gjininë, racën, etninë, përkatësinë fetare apo bindjet politike, i ka shërbyer qëllimit për të siguruar legjitimitet dhe konsensus ndërmjet palëve lidhur me planin, afrimin e komunitetit në vendimarrje, rritjen e nivelit të transparencës së autoriteteve vendore gjatë ushtrimit të detyrave të veta administrative, dhe shkallës së ndërgjegjësimit mbi gamën e shqetësimeve dhe pritshmërive që mbart komuniteti vendas, të gjitha këto si elemente të rëndësishëm për një qeverisje të mirë.

Duke përcaktuar axhendën e zhvillimit të zonës, Plani i Zhvillimit të Bashkisë Kukës i shërben rritjes së mirëqënies të gjithë komunitetit. Plani identifikon një proces të tërë, në të cilin angazhohen jo vetëm strukturat e administratës lokale të Bashkisë, por edhe aktorët kryesorë, grupet e interesit dhe banorët e Kukësit.

Në sajë të përfshirjes së komunitetit në procesin e përgatitjes së tij, Plani i Zhvillimit orientohet sipas koncepteve vizionare të komunitetit në lidhje me zhvillimin. Duke qënë se në mentalitetin tonë të zhvillimit dhe të planifikimit kanë munguar modelet vizionare, që shpjegojnë se ku dhe si do të orientohen

potencialet ekzsituase, plani i propozuar i bashkëngjitet me një ekuilibër më të arrirë zhvillimit rajonal të Kukësit, duke u koordinuar sipas të gjitha fushave përkatëse.

Plani i Zhvillimit është konceptuar si një lloj kontrate aksionesh midis autoriteteve vendore dhe qytetarëve, e cila specifikon llojin, sasinë dhe formën e zhvillimit, duke mbrojtur me çdo kusht mjedisin dhe vlerat. Për këtë arsye plani është i fokusuar të ndërtojë një program pune me një plan veprimesh konkrete, që synon të fillojë dhe të influencojë proceset e ardhshme të zhvillimit. Plani adreson premtimet e bëra nga Kryetari i Bashkisë Kukës gjatë fushatës zgjedhore, nevojat bazë, kërkesat dhe sfidat e banorëve, nëpërmjet shfrytëzimit racional të potencialeve dhe burimeve ekzistuese.

Duke u bazuar në ligjin ekzistues të Qeverisjes Vendore në Shqipëri, Plani i Zhvillimit të Bashkisë Kukës e ka konsoliduar vlerën e tij ligjore dhe detyruese për zbatim, që në momentin e miratimit nga Këshilli Bashkiak Kukës.

Promovimi i zhvillimit ekonomik lokal, furnizimi me shërbimet bazë publike, mbrojtja e mjedisit, përmirësimi i kontrollit mbi territorin dhe proceset e planifikimit urban janë ndër detyrat kryesore për çdo njësi vendore. Të gjitha këto kanë nevojë për planifikim, për të siguruar kështu një zhvillim koherent dhe të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, Plani i Zhvillimit plotëson këto kritere:

- a) ai është një dokument që orienton veprimet e bashkise duke e mundësuar këtë të fundit, që të veprojë sipas një vijimësie të qartë procesesh dhe aktiviteteve në vite,
- b) plani i mundëson komunitetit lokal që të përpunojë një vizion të përgjithshëm, për të ardhmen e njësisë vendore, duke përcaktuar në të njëjtën kohë edhe misionin e autoriteteve vendore,
- c) plani është një instrument që propozon një seri projektesh dhe veprimesh, të cilat bashkia mund t'i adresojë në qeverinë qendrore apo në partnerë të tjerë financiarë si psh: në agjencitë donatore, për të siguruar kështu financime të vazhdueshme,
- d) ai është një instrument që vjen si rezultat i një procesi pjesëmarrës, gjatë të cilit banorët kanë mundur që të përcaktojnë nevojat e tyre si dhe prioritetet për veprim,
- e) plani trajton të gjitha çështjet prioritare që shqetësojnë jetën e përditshme të banorëve,
- f) plani është i njohur nga banorët dhe i lejon autoriteteve të bashkise që të veprojnë në mënyrë transparente në mbështetje të tyre,
- g) plani është një dokument që lejon veprime efektive, duke përfshirë në vetvete një proces monitorues, i cili mundëson rishikimin periodik të objektivave dhe veprimeve, vetë banorët janë të përfshirë në procesin e rishikimit.

Plani është fleksibel dhe krijon hapësira për ndryshime të mundshme të bazuara në kriteret e nevojave që mund të dalin si pasojë e situatave të ndryshme të paparishikuara, zhvillimeve të reja dhe përmirësimeve të vazhdueshme, që do të dalin si rezultat i punës së pushtetit vendor përgjatë zbatimit. Pa dyshim këto ndryshime do të realizohen duke iu referuar kërkesave dhe nevojave specifike, sipas grupeve përkatëse të interesit.

Plani i Zhvillimit është hartuar duke u bazuar në mundësitë reale të Bashkise Kukes, si në kuptimin e këndvështrimit të burimeve njerëzore ashtu dhe të atyre financiare, ndërkohë pa munguar dhe shmangur ato ndërhyrje të rëndësishme strategjike, të cilat mund të shkojnë përtej kapaciteteve apo burimeve ekzistuese të Bashkisë.

Plani është transparent në kuptimin se ky dokument në vetë llojin e tij është i hapur ndaj propozimeve të përfshira, që janë diskutuar nga vetë komuniteti, biznesi apo grupe të tjera, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm. Në këtë mënyrë Plani i Zhvillimit nxit rritjen e besimit përkundrejt pushtetit vendor, dhe përgjegjshmërinë gjatë kohës së zbatimit të tij.

Pa dyshim që administrata e Bashkise Kukes mbetet aktori kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti, në linjë me procesin periodik të

planifikimit dhe të buxhetimit. Të tjerë aktorë të përfshirë në proces do të japin ndihmesën e tyre në monitorimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të planit.

Nga ana tjetër, për shkak të tranzicionit në vazhdim, në Shqipëri priten ndryshime të shumta, që do të reflektohen padyshim në rajonin e Kukës dhe në Bashkinë Kukës. Për këtë arsye rishikimi i Planit të Zhvillimit duhet të jetë një subjekt reflektimi i vazhdueshëm. Plani duhet të rishikohet në mënyrë periodike, duke adoptuar dhe integruar ndryshimet e shkaktuara nga zhvillimet apo tendencat e reja të tranzicionit në Shqipëri.

IV. HAPAT E NDJEKUR NE HARTIMIN E PLANIT TE VEPRIMIT (PV)

Nr	Aktivitetet	Kush	Koha	Vendi
1	Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Veprimit	Stafi RASP	Shkurt 2012	Kukës
2	Trajnimi i anëtarëve të grupit për “Pjesëmarrja e komunitetit në vendim marrje”	Stafi RASP	Mars 2012	Kukës
3	Mbledhja e të dhënave	Grupi i punës	Mars-Prill	Kukës
4	Analiza e situatës	Grupi i punës	Prill	Kukës
5	Takime me grupet e interesit - Grupi i senatorëve të shkollës së mesme Kukës - Grupi i të rinjve universitare - Grupi i grave - Grupi i pensionistëve - Grupi i biznesit - Grupi i intelektualëve	Grupi i punës	Maj-Qershor Korrik	Kukës
6	Krijimi i grupit konsultativ	Grupi i punës, Drejtuesit e Bashkisë	Gusht	Kukës
7	Përpunimi i draftit		Korrik Gusht	Kukës
8	Marrja e vërejtjeve, sugjerimeve të komunitetit dhe konsultime me Këshillin Bashkiak		Gusht Shtator	Kukës
9	Miratimi në Këshillin Bashkiak		Shtator	Kukës

Qyteti i Kukësit është i vendosur 3 km në jug-lindje të Kukësit të vjetër, në rrafshin e Lumës dhe brigjet e liqenit të Fierzës. Ka një shtrirje veri-jug prej 1.4 km dhe lindje-perëndim prej 0.9 km. Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 820 ha dhe lartësi mesatare 340-350 mbi nivelin e detit. Ai kufizohet në veri me Liqenin e Fierzës, në Lindje me Komunën e Tërthores, Në Jug me Komunën Shtiqen dhe në Perëndim me Komunën e Shtiqnit dhe Kolshit.

2. Karakteristikat natyrore

Klima është tipike kontinentale. Vera është e nxehtë e me pak reshje dhe dimri i ftohtë me shumë dëbore e ngrica. Temperaturat mesatare vjetore variojnë nga 11-11.9 °C. Në verë temperaturat shpesh kalojnë mbi 25°C, ndërsa në dimër ato minimale mund të zbrasin deri në -25°C. Reshjet vjetore renditen në diapazon 900-3000mm dhe rreth 80% e tyre bien në periudhën Tetor-Mars.

Pellgu kryesor ujmbledhës i rajonit është ai i lumit Drin (Drini i Bardhë dhe Drini i Zi), të cilët në këtë pjesë formojnë liqenin e Fierzës. Ky liqen shfrytëzohet kryesisht për energji elektrike.

Qyteti i Kukësit ka një pozicion strategjik për zhvillimin e vendit. Ndertimi i autostradës në 2010 ka shkurtuar distancën e Kukësit jo vetëm me qytetet brenda Shqipërisë por edhe më gjerë. Tani qyteti i Kukësit shërben si pikë lidhëse mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Gjithashtu aeroporti i Kukësit ndërtuar në 2004 është një favor me perspektivë për këtë zonë duke qënë aeroporti i dytë me i madh në Shqipëri.

C. Popullsia

Sipas statistikës së fundit të vitit 2011, Bashkia Kukës ka një popullsi prej 23.060 banorë, nga e cila rreth 20500 banorë janë në qytet, ndërsa 2560 banorë jetojnë në 3 fshatrat në juridiksion të Bashkisë. Aktualisht janë 4761 familje me 4.9 banor/familje.

Table 1 Të dhëna për popullsinë

Lagje - Fshati	Popullsia	Meshkuj	Femra	Nr familjeve
Lagje Nr 1	2961	1490	1471	574
Lagje Nr 2	2831	1418	1413	559
Lagje Nr 3	3219	1614	1676	633
Lagje Nr 4	2527	1304	1223	470
Lagje Nr 5	3219	1586	1633	609

Lagje Nr 6	4513	2262	2251	821
Lagje Re + Kulla Lumes	1315	662	653	505
Gostil	2191	1115	1076	513
Drinas	284	135	149	77
TOTALI	23060	11586	11545	4761

Burimi i informacionit – Gjendja Civile

D. Ndihma ekonomike

Si rezultat i mbylljes se minierave, uzinës dhe të shumë ndërmarrjeve ekonomike që trajtonin një numër të madh punëtorësh, papunësia është shumë e madhe në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Këtë gjë e rëndon akoma më tepër edhe numri i banorëve të fshatrave për rreth qytetit që punësohen në administratë ose bizneset private, duke ulur shanset e banoreve të qytetit për punësim. Numri total i familjeve me ndihmë ekonomike është 2035.

Table 2 Familje me ndihmë ekonomike

Nr	Lagje - Fshati	Numri i familjeve gjithsej	Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike	% e familjeve që marrin ndihmë ekonomike
	Lagje Nr 1	574	294	51.2
	Lagje Nr 2	559	234	41.9
	Lagje Nr 3	633	294	46.5
	Lagje Nr 4	470	215	45.7
	Lagje Nr 5 + Drinas	686	267	38.9
	Lagje Nr 6	821	248	30.2
	Lagje Re + Kulla Lumes	505	298	59
	Gostil	513	185	36.1
	Totali	4761	2035	42.8

Burimi i informacionit – Dr. e Ndihmës Ekonomike Bashkia Kukës

E. Strehimi dhe urbanizimi

E vështirë paraqitet situata e strehimit. Eshtë e vështirë që banorët të përfitojnë strehim nga fondet e Bashkisë. Nga studimet e kryera në qytetin e Kukësit, duke parë dhe zhvillimin demografik dhe atë urban, vëmë re se ka progres në disa aspekte. Megjithatë këto vitet e fundit popullsia e qytetit nuk është rritur (ka ndryshime të vogla), qyteti ka marrë një zhvillim në aspektin urban ku janë realizuar shume ndërtime të reja banesash private kryesisht në Lagjen e Re si dhe në fshatrat rreth qytetit e rrethinat e tij.

Pranë bashkisë Kukës kanë aplikuar për statusin si të pastrehë 463 familje. Nga këto familje kanë përfituar kredi të lehtësuara nga Enti Kombëtar i Banesave 115 familje dhe pritet që të përfitojnë dhe 130 familje të tjera gjatë vitit 2012. Parashikohet që në vitet në vazhdim të përfitojnë nga 50 familje në vit kredi për strehimin.

F. Furnizimi me Ujë të pijshëm

Duke parë zhvillimin e viteve të fundit, vihet re se dhe nevojat për ujë të pijshëm janë në rritje. Aktualisht, në qytet furnizimi me ujë bëhet nga dy ujësjellës (Kolesian dhe Lojme), të cilët janë ndërtuar në vitet 1994-2000, por ato nuk garantojnë furnizim ritmik të banorëve. Bashkia Kukës ka 166 km linja tranzit të ujit të pijshëm.

Problematike në këtë aspekt është furnizimi me orar dhe pamundësia e furnizimit me ujë për person. Kriteri themelor i planifikimit të sasisë ditore të ujit në qytet duhet të jetë që komuniteti të ketë ujë pa ndërprerje gjatë gjithë ditës në rrjetin e shpërndarjes dhe me presion të stabilizuar. Sasia e ujit që duhet të përdoret nga një person sipas normave aktuale është 150 litra në ditë. Nga studimet e kryera, ka rezerva të konsiderueshme ujore, por për shkak të infrastrukturës jo të mirë që ekziston nuk kemi furnizim të rregullt me ujë. Ka ndërhyrje të paligjshme në rrjetin e ujësjellësit përgjatë shtrirjes së tij por edhe keqpërdorim të tij nga lokalet private dhe lavazhet e shumta. Megjithatë ka filluar ndërtimi i ujësjellësit të ri që në vitin 2011, ritmet e punës janë shume të ngadalta dhe duhet ndërhyrje e Bashkisë pranë institucioneve përgjegjëse përkatëse për përfundimin sa më shpejt të tij, duke garantuar furnizimin ritmik 24 orë me ujë të pijshëm.

G. Rrjeti i kanalizimeve

Në juridiksionin e Bashkisë Kukës është Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve që merret me administrimin e këtij procesi. Gjatë viteve të fundit është bërë rikonstrukcion i plotë i magjstralit kryesor të ujrave të zeza dhe u ndërtua i ri ai në Lagjen e Re. Bashkia Kukës ka 31.8 km kanalizime të

ujrave të zeza. Por duhet theksuar se kolektori kryesor që mbledh të gjithë rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza derdhet në Liqenin e Fierzëz. Këto ujëra janë të patrajtuara, ç'ka përbën një faktor të lartë ndotjeje të ujërave të liqenit dhe shtim të sëmundjeve diareike, të lëkurës, etj. Për këtë qëllim kërkohet ndërhyrje e menjëhershme për përpunimin e tyre përpara derdhjes në liqen.

H. Burimet dhe përdorimi i energjisë

Lagjet e qytetit dhe fshatrat në juridiksion të Bashkisë Kukës, furnizimin me energji e merr tërësisht nga rrjeti kombëtar. Burime alternative janë Gazi natyror dhe drutë e zjarrit që aktualisht përdoren më pak. Energjia elektrike përdoret përgjithësisht për ndriçim, gatim e ngrohje, por si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe druve të zjarrit, vitet e fundit vihet re një përdorim më i gjere i gazit si për gatim edhe ngrohje.

I. Sistemi arsimor

Qyteti ka tradita arsimdashëse. Shkolla e parë fillore është hapur që në vitin 1929-1930, ndërsa shkolla e mesme është hapur që në vitin 1956, e cila krijoi një traditë të mirë duke u bërë e njohur në shkallë kombëtare për cilësinë e mësimdhënies dhe numrin e studentëve që vazhdonin shkollat e larta.

Sot aktualisht në Bashkinë e Kukësit ka 6 shkolla 9-vjeçare me 3701 nxënës dhe një shkollë të mesme ku studiojnë rreth 1501 nxënës. Bashkia ka edhe 3 çerdhe dhe 3 kopshte me rreth 780 fëmijë. Cilësia e punës në këto institucione është në parametra të lartë kombëtare. Megjithatë duhet thënë se nevojat në këtë drejtim nuk plotësohen, pasi ka shumë kërkesa nga qytetarët që duan të dërgojnë fëmijët e tyre në këto ambjente.

Ka një qendër kulturore për fëmijë, e cila përveç aktiviteteve të tjera, po krijon traditë të përvitshme në organizimin e një festivali për fëmijët, i cili zhvillohet në muajin Qershor

Ne vitin 2007 është hapur Universiteti i Tiranës filiali Kukës me tre degë: Gjuhë e Huaj, Infermeri, Ekonomik. Aktualisht janë afërsisht 800 studente nga rrethet e ndryshme të vendit që ndjekin studimet e tyre në filialin e Kukësit. Njëkohësisht, në qytetin e Kukësit funksionojnë dy universitete private Medicom dhe Kristal.

Table 3 Të dhëna për edukimin

	Çerdhe e Kopshte			Shkolla 9vjeçare			Shkalla të mesme		
	Nr	Fëmije	Edukatore	Nr	Nxenes	Mesues	Nr	Nxenes	Mesues
Bashkia Kukës	3	780	62	6	3701	190	1	1501	67

Burimi i informacionit – Bashkia Kukës

J. Shendeti publik

Në Bashkinë Kukës funksionon Spitali Rajonal i cili ofron shërbime mjekësore për banorët e Bashkisë dhe të gjithë Rajonit. Në territorin e Bashkisë Kukës ushtrojnë aktivitetin e tyre ISKSH (Dega Rajonale) dhe Drejtoria Rajonale Shëndetsore që ka për banorët e Bashkisë Kukës shërbimin e mjekut të familjes (24 orësh) në të cilin shërbejnë 9 mjekë dhe 43 persona personel tjetër mjekësor. Në shërbim të banorëve janë:

Një maternitet Rajonal

Një konsultore për nënat dhe fëmijët

Shërbimi i Urgjencës (brenda spitalit)

Shërbimi stomatologjik për fëmijë

Në shërbim të banorëve janë dhe 6 farmaci private.

Table 4 Te dhena për spitalet dhe personelin mjekësor

Emërtimi	Spitale	Qendër Shëndetsore	Ambulanca	Nr mjekëve në shërbim parësor	Nr infermiereve në shërbim parësor
Bashkia Kukës	1	1	2	9	43

Burimi i informacionit – Qarku Kukës

K. Mjedisi

1. Gjelbërimi

Komuniteti gëzon një frymë bashkëpunuese që vihet re në kërkesat për përmirësimin e kushteve mjedisore të qytetit dhe në nismat e ndryshme të institucioneve. Gjate mandatit të kaluar Bashkia ka bërë ndërhyrje të konsiderueshme në drejtim të rritjes së sipërfaqeve të gjelbërimit në brendesi të lagjeve të qytetit, por kjo gje duhet të shoqerohet dhe me procesin e mirmbajtjes dhe ndergjegjësimin të komunitetit për ruajtjen e tyre.

Nevoja për organizime qytetare në OJF apo grupime të tjera në dobi të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe mjedisit është gjithnjë e në rritje, kjo e lidhur drejtpërdrejt me rritjen e qytetit dhe problematikave të zhvillimit të tij.



Shtimi dhe përmirësimi i mjedisëve të gjelbra është një tjetër element, i cili duhet të merret në konsideratë për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe estetik. Kjo në radhë të parë kërkon përcaktimin konkret në terren të zonave të gjelbra, dhe specifikimin e instrumenteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Ekzistenca e burimeve të shumta ujore duhet të shfrytëzohet nga autoritetet dhe banorët e zonës, si një potencial për krijimin dhe shtimin e zonave të gjelbra.

Table 5 Siperfaqjet e gjelberta ne m²

Vendndodhja	Siperfaqe te gjelberta ne qytet	
	Njesia	Sasia
Lulishte në Lagjen nr 1	m ²	8.800
Lulishte në Lagjen nr 2	m ²	6.500
Lulishte në Lagjen nr 3	m ²	6.200
Lulishte nëLagjen nr 4	m ²	3.770
Lulishte në Lagjen nr 5	m ²	26.100
Lulishte në Lagjen nr 6	m ²	3.600
Lulishte në Lagjen e Re	m ²	0
Lulisht në Gostil	m ²	2.500
Fidanishte dekorative e Bashkisë	m ²	35.700
Breza pyjore mbrojtës	m ²	36.000
Parku i zabelit	m ²	28.000
TOTAL LULISHT BASHKIA	m ²	157.170
Siperfaqje lulishte për banorë	m ²	7,05
Drurë dhe shkurre dekorative total Bashkia	Cope	11.358
Gardh i gjelbër total Bashkia	ml	7.321

Burimi i informacionit – Dr e Sherbimeve Bashkia Kukës

L. Mbetjet urbane

Mbetjet urbane janë një element mjedisor që lidhet me shëndetin e njerëzve dhe cilësinë e mjedisit. Ato përbëhen nga mbetjet shtëpiake dhe ato që prodhohen nga tregtia, artizanati, etj. Këto mbetje hidhen nëpër kontenerë dhe më tej dërgohen në fushën e depozitimit. Aktualisht, në Kukës mbledhja e mbeturinave bëhet e padiferencuar, dhe të gjitha ato hidhen në të njëjtën vend depozitim dhe kur ai mbushet plot, mbulohet me dhe braktiset, duke sjellë dekompozimin anaerobik të mbeturinave, gjë që sjell prodhimin e gazit metan, dhe krijon nevojën për hapje të një vend depozitimi të ri sa herë që ai ekzistuesi mbushet. Qyteti i Kukësit prodhon deri në 8 ton mbeturina në ditë, nga të cilat rreth 40 % janë mbeturina organike (3.2 ton afërsisht). Bashkia Kukës ndërtoi vend depozitimin e dytë të qytetit 2 vite më parë, e nisur nga nevoja gjithnjë e në rritje për vend-depozitim mbeturinash. Një ndarje e mbeturinave organike nga ato inorganike do të lehtësonte shumë riciklimin në të ardhmen e afërt të këtyre të fundit pasi të jenë vendosur bazat për



riciklimin e tyre ose biznese ricikluese shfaqin një interes për to. Edukimi dhe ndërgjegjësimi është një nga problemet kryesore, që do të lehtësonte shumë punën në të ardhmen, për futjen e mbledhjes së diferencuar për të gjitha mbeturinat që hidhen në kazanë (qelq, letër, dru, metale etj).

M. Infrastruktura rrugore

Duke qënë një qytet i ri, Kukësi ka një rrjet rrugor të sistemuar që përshkon të gjithë lagjet e qytetit. Megjithë përpjekjet e bëra për mirëmbajtjen ose rikonstruksionin e disa prej tyre, gjendja paraqitet jo e mirë, kjo edhe për shkak të ndërhyrjeve si rezultat i ndërtimit të ujsjellsit të ri. Kjo gjë është bërë shqetësuese për banorët dhe për pastertinë e ambjentit, prandaj kërkohej ndërhyrje urgjente për përmirsimin e gjendjes.

Gjatësia e rrugëve në qytet është afërsisht 7.5 km me sipërfaqe 113.780 m² dhe me rreth 46.567m² trotuare.



N. Bizneset dhe punësimi

Ekonomia është disi e pazhvilluar, por duhet të theksojmë Bashkia Kukës ka më shumë mundësi se bashkitë e tjera fqinjë, pasi gjeografikisht është e pozicionuar në një pikë të favorshme. Ajo është afër tregut të Kosovës e veçanërisht me dy qytetet kryesore të tregtisë së Kosovës, Prizrenin dhe Gjakovën. Po kështu është afërsisht dhe me tregjet e tjera të vendit, si rezultat i ndërtimit të autostradës Durrës – Kukës.

Perpara viteve '90, banorët e Kukësit kanë qënë të angazhuar në aktivitete të tilla si minierat, sektori i tregtisë, industrisë së lehtë ushqimore, punimet artizanale, ndërtim etj. Pas '90, pothuajse tërë këto aktivitete shtetërore u mbyllën, gjë që çoi në rritjen e papunësisë dhe varfërisë për banorët.

Sot sektoret kryesore të punësimit janë sektori i tregtisë dhe mallrave, sektori i shërbimeve, sektori i transportit dhe pjesa tjetër që janë me të pakta jënë sektori prodhues dhe ai i ndërtimit, i cili bazohet kryesisht në kontraktimet publike.

Bashkia e Kukësit ka një normë të lartë papunësie. Mbi 35 % e popullsisë së afte për punë është e papunë. Numri i bizneseve është akoma shumë i ulët dhe situata e tyre është e keqe. Shumica kanë probleme financiare dhe me taksat duke mos pasur burime të mjaftueshme për investime të metejshme. Punësimi është i ulët në sektorin privat dhe shumica punojnë në sektorin publik. Të ardhurat mesatare mujore janë mjaft të ulta për shkak se shumë

familje jetojne me ndihme ekonomike. Shumica e familjeve jetojne me rroga nga sektori publik qe ka nje mesatre prej 19.000 lekesh. Duke gene se niveli jetik eshte mesatarisht i njëjte me të ardhurat mesatare për familje, kuptohet që shumica e familjeve jetojnë nën nivelin jetik dhe niveli i të ardhurave është i pamjaftueshëm për të përballuar një jetesë normale.

Table 6 Të dhëna për biznesin

Emërtimi	Biznese prodhuese		Shërbime		Të tjera	
	Nr	Të punësuar	Nr	Te punësuar	Nr	Të punësuar
Bashkia Kukës	16	24	97	97	203	203

O. Te ardhurat e Bashkisë Kukës

Figure 1 Administrata e Bashkisë Kukës

Viti	Nr.persoelit sipas strukturës	Administratë	Punonjës	Nr.Faktik në total	Me arsim të artë (ose në vazhdim)	Me arsim të mesëm	Meshkuj	Femra	Femra në poste drejtuese
2011	252	69	183	238	48	140	148	90	10
2012	255	80	175	225	55	120	126	99	9

Burimi i informacionit – Dr Ekonomike Bashkia Kukës

Table 7 Grandet dhe buxheti sipas viteve 2010 – 2012 ne 000 leke

Emertimi	Viti 2010		Viti 2011		Viti 2012	
	Grand	Buxheti	Grand	Buxheti	Grand	Buxheti
Bashkia Kukës	90.531	159.063	98.018	252.047	97.479	271.674

Burimi i informacionit – Dr Ekonomike Bashkia Kukës

P. Shperndarja e buxhetit per vitin 2012

Table 8 Buxheti per vitin 2012 – Bashkia Kukës

Emertimi	Buxheti gjithsej 000/ lek		Shperndarja sipas zerave kryesor										
	000/Leke	%	Investime	Kopshte + Çerdhe	Sherbime publike	Qendra kulturore	Konvikti	Administrat a	Te tjera				
Bashkia Kukes	271.674		13.744	29.149	65.602	12.801	55.379	77.975	17.024				
		5.1		11	23.6	4.6	20	30	6.1				

Burimi i informacionit – Dr Ekonomike Bashkia Kukës

VI. VIZIONI PER VITIN 2015

KUKESI, QYTET BASHKEKOHOR

I urbanizuar me shërbime publike te përmiresuara dhe më afër qytetarit

I orientuar në drejtim të agrobisnesit dhe turizmit të brendshëm dhe ndërkufitar.

Me kushte jetese të përmirësuar dhe në rritje, me qytetar të respektuar dhe të rëndësishëm për qeverisjen vendore.

Qendër e rëndësishme e zhvillimit ekonomik, turistik, arsimor, kulturor e sportive.

A. Objektivat e përgjithshëm të zhvillimit te Bashkisë Kukës

Do të ruhet dhe përsoset tradita e krijuar deri tani në gjitha aktivitetet dhe shërbimet ndaj qytetarëve.

Rritja e nivelit të jetës, ulja e papunësisë, nëpërmjet implementimit të planit të zhvillimit të bashkisë e në veçanti e planit për zhvillimin e turizmit.

Mbështetje per biznesin vendas me politika fiskale lehtësuese, stimulimi dhe mbështetje për biznesin artizanal dhe prodhues vendas.

Njohja e pronave te ish ndërrmarrjes bujqësore Kukës (Gostil , Kukës , shtraze , etj)

VII. MATRICA E PROJEKTEVE SIPAS PREMTIMEVE TE KRYETARIT TE BASHKISE KUKES

Table 9 MATRICA E PROJEKTEVE

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
1	Ndërtimi i tregut industrial qytetit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Studimi fizibilitetit ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shfrytëzimi me kriter i mjediseve urbane ▪ Cilësi më e lartë shërbimi ndaj qytetarëve 	2015	125.000	Qeveria Shqiptare + Donatore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Tregu i ndërtuar ▪ Nr i tregtuesve të vendosur në treg
2	Rikonstruksion i plotë i të gjithë rrugëve të qytetit, prioritet asfaltimi i rrugëve në lagjen e RE dhe Bozhe	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritja e cilësisë së jetesës ▪ Eleminimi i ndotjes së ajrit nga pluhurat ▪ Rritja e numrit të shërbimeve 	2015	91.061	MPPT	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit ▪ Niveli i ngritjes së pluhurave ▪ Numri i familjeve përfituese
2/1	-Vazhdim i rrugës hyrëse të Kukësit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 	2012	8.970	MPPT	<ul style="list-style-type: none"> ▪

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
2/2	Rikonstruksion rrugë katesh-xhami 6	Zbatimi i projektit		2012	14.913	MPPT	
2/3	Rikonstruksion rrugë gomisteri i seberve-lagje re	Zbatimi i projektit		2013	17.623	MPPT	
2/4	Rikonstruksion rrugë dega ushtarake - stacioni autobuzave	Zbatimi i projektit		2013	10.030	MPPT	
2/5	Rikonstruksion rrugë Maliq Cena-Ujesjellës	Zbatimi i projektit		2012	12.615	MPPT	

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
2/6	Asfaltimi i rrugëve të brendshme dhe trotuaret në lagjt Nr 1+2+3	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	▪	2012-2013	3.200	MPPT	▪
2/7	Asfaltimi i rrugëve të brendshme dhe trotuaret në lagjet 4+5+6+Zabel	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	▪	2013-2014	3.150	MPPT	▪
2/8	Asfaltimi i rrugëve të brendshme dhe trotuaret në lagjet Gostil, Drinas	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	▪	2015	1.060	MPPT	▪

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
2/9	Asfaltim i rrugës Karburant vjetër, artizanat, banjot e qytetit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 	2015	5.500	MPPT	<ul style="list-style-type: none"> ▪
2/10	Ndriçim i rrugës Radio - 6 katesh	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësi më e lartë shërbimi ndaj qytetareve ▪ Ulje e aksidenteve në rrugë 	2012	14.000	Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit ▪ Numri i familjeve përfituese
3	Restaurim dhe rikonstruksion i plotë i varrezave të dëshmorëve të qytetit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis i pastër 	2013	3.500		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit
4	Ndriçim i plotë i të gjithë lagjeve të qytetit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilësi më e lartë shërbimi ndaj qytetarëve ▪ Ulje e aksidenteve në rrugë 	2015	2.100	Qeveria Shqiptare + Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit ▪ Numri i familjeve përfituese ▪ Ndryshimi i nr aksidenteve

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
4/1	Lagje nr 1+2	▪	▪	2013		Qeveria Shqiptare + Bashkia Kukës	▪
4/2	Lagje nr 3+4	▪	▪	2012-2013		Qeveria Shqiptare + Bashkia Kukës	▪
4/3	Lagje nr 5+ 6+ Zabel	▪	▪	2014		Qeveria Shqiptare + Bashkia Kukës	▪
4/4	Lagje e Re	▪	▪	2015		Qeveria Shqiptare + Bashkia Kukës	▪
5	Vendosja e sinjalistikës bashkëkohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Cilesi më e lartë shërbimi ndaj qytetarëve ▪ Ulje e aksidenteve në rrugë 	2013	1.600	MPPT	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit ▪ Nr i aksidenteve në rrugë

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
6	Shtimi i sipërfaqeve të gjelberta dhe ambjenteve çlodhëse në cdo lagje. Lagje 1+2+3 Lagje 4+5+6+zabel	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis i paster ▪ Ambjente çlodhëse për banorët ▪ Cilësi më e lartë shërbimi ndaj qytetarëve 	2012 - 2015	1.500 2.500	Qeveria Shqiptare + Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit ▪ Sip m² gjelbërim i shtuar
7	Ndërtimi i Ujësellsit me ujë industrial.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritja e sasisë së ujit për nevoja të qytetarëve dhe gjelbërimit 	2014-2015	9.600	Qeveria Shqiptare Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sasia e sipërfaqeve të gjelbërta të vaditura ▪ Parametrat e cilësisë së ajrit

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
8	Ndërtimi i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Percaktimi i vendit të përpunimit ▪ Shpronësimi i truallit ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis i pastër ▪ Rritje e punësimit 	2014 - 2015	4.600 9.560	MPPT + Donatore + Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit ▪ Nr i te punsuarve
9	Studimi i projektimit të unazës turistike të qytetit (turizmi i ri, kurora mbipasqyrë e liqenit shëtitore).	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i studimit ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis i pastër ▪ Ambjente çlodhese për banoret ▪ Cilësi më e lartë shërbimi ndaj qytetarëve 	2013 - 2015	60.000	MPPT + Donatore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Projekti teknik ▪ Zbatimi i projektit ▪ Gjatsia e shetitores së ndërtuar

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
10	Perfundimi i ujësjellësit të ri dhe zgjidhja përfundimtare e furnizimit me ujë të pijshëm i qytetarëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Furnizimi 24 ore me ujë të pijshëm për gjithë banorët 	2013	440.000	MPPT	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sasia e orëve me ujë të furnizuar ▪ Cilësia e ujit
11	Lyerja e fasadave të rrugëve kryesore të qytetit dhe më gjerë.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i studimit ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis i pastër dhe i bukur ▪ Rritje e punësimit 	2013-2015	2.800	Qeveria Shqiptare Bashkia Kukës Banorët bashkëfinancim	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Studim i përfunduar ▪ Projekt i hartuar dhe zbatuar ▪ M² të sipërfaqeve të fasadave të përmirsuara

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
12	Vazhdimi me përparësi i strehimit të qytetarëve, strehimi i 130 familjeve në vitin e parë të mandatit.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bashkëpunimi me Entin Kombëtar të Banesave dhe Qeverinë për sigurimin fondeve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësimi i kushteve të jetesës në familje ▪ Minimizimi i nr familjeve pa banesa në qytet (50 familje çdo vit) 	2012 2013 2014 2015	10.000 10.000 10.000 10.000	Enti Kombëtar i Banesave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i familjeve që sigurojnë strehim ▪ Numri i kredive të dhëna për strehimin
13	Hapja e një shkolle të mesme profesionale e ndarë nga shkolla e mesme të përgjithshme.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i studimit ▪ Hartimi i projektit ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mundësi më të medha për të vazhduar arsimin e mesëm profesional 	2015		Min Arsimit, Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Studim i përfunduar ▪ Projekt i hartuar dhe zbatuar ▪ Numri i nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm profesional
14	Ndertimit i shkollës 9-vjecare në lagjen e re.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësimi i kushteve të mësimin dhe sa më afër nxënësve 	2013	16.500	Min Arsimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkolla e ndertuar ▪ Numri i nxënësve dhe mësuesve në shkollë ▪ Numri i familjeve përfituese

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
15	Mbështetje për nxënësit e talentuar në shkolla.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendim i Këshillit Bashkiak për fondin nevojshëm 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbështetja me fonde për nxënësit e talentuar ▪ Konkureshmëria 	Çdo vit	500	Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i nxënësve përfitues ▪ Sasia e fondit të dhënë
16	Mbështetje me bursë 1/2 bursës për nxënësit dhe studentët e familjeve me mundësi të pakta ekonomike.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbështetje me bursa e ½ bursa 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sigurimi i mundësive për vazhdimin e arsimimit për nxënësit ne nevojë 	Çdo vit	1.000	Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i nxënësve dhe studentëve që kane përfituar bursë ose ½ bursë ▪ Sasia e fondit të dhënë
17	Hapja e 3 degeëve të reja në Fakultetin e Kukësit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bashkëpunimi me Universitetin 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimi i mundësive për vazhdimin e arsimit të lartë në Kukës 	2013 - 2014		Min. Arsimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i degëve të reja të hapura ▪ Numri i studenteve që vazhdojnë studimet

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
18	Ndërtimi i muzeut etnografik të Kukësit dhe ai i Luftes së Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi i projektit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pasqyrimi i vlerave etnografike të rajonit ▪ Mundësi e turistëve për tu njohur me këto vlera 	2012	17.000	UNDP	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Muzeu i përfunduar ▪ Numri i produkteve të pasqyruar ▪ Numri i vizitorëve
19	Ndërtimi i stadiumit të ri në Kukës.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartim projekti ▪ Zbatim projekti 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësim i kushteve të stërvitjes ▪ Mjedis meë kulturor për shikuesit ▪ Të ardhura të siguruara 	2012	95.000	Bashkia Federata e Biznesi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Stadiumi i përfunduar ▪ Sasia e të ardhurave të siguruara ▪ Numri i te punësuarve
20	Ngritja e ekipit të volejbollit për femra të Kukësit.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përzgjedhja e stafit teknik dhe ekipit ▪ Krijimi i kushteve për stërvitje 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 	2013		Bashkia Kukës Federata	<ul style="list-style-type: none"> ▪
21	Hapja e kinemasë së re për fëmijet.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartim projekti ▪ Zbatim projekti 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kushte më të mira për arëtimin e fëmijëve ▪ Kushte për aktivitete kulturore të fëmijëve 	2014	6.500	Min Arsimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kinemaja e përfunduar ▪ Numri i aktiviteteve kulturore-artistike të zhvilluara

PLANI I VEPRIMIT 2012-2015, BASHKIA KUKES

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
22	Mbështetje për moshën e tretë, përkujdesje të vazhdueshme për ta nëpërmjet programeve të ndryshme të MPCPS dhe me OJF-të vendore dhe të ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hapja e një salle të re për pensionistet ▪ Përmirësimi i kushteve të punës në zyrën e veteranëve ▪ Subvencion për sallat e takimeve dhe aktivitete të ndryshme të veteranëve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kushte më të mira për kalimin e kohës së lirë ▪ Kushte më të mira pune zyrë të organizeës ▪ Bashkëpunim më i mirë në organizimin e mbështetjen e aktiviteteve të përbashkëta 	2013 Çdo vit		Bashkia Kukës + MPCS + OJF + Donatorë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Salle e re për pensionistët e hapur ▪ Kushtet e punës në zyrë të përmirësuara ▪ Numri i aktiviteteve të përbashkëta ▪ Shuma e subvencionit të dhënë
23	Partneritet dhe mbështetje në veprimtarinë e OJF-ve vendore dhe të tjera	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bashkëpunim i ngushtë me të gjithë OJF ▪ Krijim i kushteve dhe bashkëpunim e mbështetje për të gjitha aktivitetet 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritja e bashkëpunimit të stafit drejtuesve të Bashkisë me OJF ▪ Mbështetje e bashkefinancimit për projekte të përbashkëta 	Çdo vit		Bashkia Kukës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i takimeve të Stafit Bashkisë me OJF ▪ Numri i projekteve të përbashkëta të hartuara e zbatuara

**VIII. VENDIMI I KESHILLIT BASHKIAK PER MIRATIMIN E
PLANIT TE VEPRIMIT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

Adresa: Sheshi "Skënderbej" Kukës Tel: +355 24222513 Fax: +355 24222313
Web: www.bashkiakukes.com E-mail: kryetari@bashkiakukes.com

V E N D I M

Nr. 46 /Datë 15.10/2012

**MBI MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË BASHKISË KUKËS
PËR PERIUDHËN 2012-2015**

Në baze të ligjit 8652, datë 31/07/2000 "Për miratimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"
Këshilli Bashkiak Kukës


V E N D O S I


1. Miratimin e Planit të veprimit të Bashkisë Kukës për periudhën 2012 – 2015;
2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Insitucioni Bashkia Kukes;
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Kukes;

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK



1076
23.10.2012


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS


100 Vjet Pavarësi

Adresa: Sheshi "Skënderbej"; Nr. tel & fax 0242 2378; Email: insprefektiku@gmail.com

Nr. 1/30 Prot. Kukës me 22.10.2012.

LËNDA : Verifikimi i Ligjshmërisë së Aktëve.

Për **KRYETARIN E BASHKISË
KËSHILLIN E BASHKISË
K U K Ë S**

Bazuar në nenin 14, pika 2, shkronja " b " të ligjit nr. 8927 datë 25.07.2002 "Për Prefektin", pasi verifikova Kompetencën, Juridiksionin dhe Bazën Ligjore të **vendimeve të datës 15.10.2012 të Këshillit të Bashkisë Kukës :**

- **Nr.45**, "Për miratimin e fondit të ndihmës ekonomike për muajin Shtator të vitit 2012",
- **Nr.46**, "Mbi miratimin e planit të veprimit të Bashkisë Kukës për vitet 2012-2015",

V E N D O S A :

Të konfirmoj vendimet e datës **15.10.2012 të Këshillit të Bashkisë Kukës :**

- **Nr.45**, "Për miratimin e fondit të ndihmës ekonomike për muajin Shtator të vitit 2012",
- **Nr.46**, "Mbi miratimin e planit të veprimit të Bashkisë Kukës për vitet 2012-2015".

Kaq për dijeni.

*In Malun chety
In Koshin shullur*

